



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Glllogocit
Zyra e Kryetarit



01 Nr. 020/04-34258 data 26.07. 2021

Në vështrim të nenit 13 dhe 14.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores 12 nr.320-19338 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, rregullores MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, nenit 49 të Ligjit Nr.05/L-031 Për Procedurat e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për anëtarë në cilësinë e ekspertit dhe përfaqësues të OJQ-ve në komisionit për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2021.

- I. Anëtarët e komisionit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për anëtarë në cilësinë e ekspertit dhe përfaqësues të OJQ-ve në komisionit për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2021, janë:
 1. Kajtaz Kastrati
 2. Albulena Lushtaku-Hetemi
 3. Shpend Bogiqi
- II. Komisioni ka për detyrë të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për anëtarë në cilësinë e ekspertit dhe përfaqësues të OJQ-ve në komisionit për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike, nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2021, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në Ftesën për aplikim për anëtarë të komisionit vlerësues për projektet nga fusha e kulturës, rinis dhe sportit të publikuar me 08.07.2021 dhe në Rregulloren

MF-NR 04/2017 Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve

III. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për anëtarë në cilësinë e ekspertit dhe përfaqësues të OJQ-ve në komisionit për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lartë dhe përkushtim.

IV. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për anëtarë në cilësinë e ekspertit dhe përfaqësues të OJQ-ve në komisionit për ndarjen e subvencioneve përmes thirrjes publike, ka për obligim që të shqyrtoj dhe vlerësoj të gjitha kërkesat e arritura në formë elektronike në emali-in komuna.drenas@rks-gov.net dhe në të njëjtën kohë të njoftoj me shkrim Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimin e kërkesave/aplikacioneve për një anëtarë në cilësinë e ekspertit dhe një anëtarë përfaqësues i OJQ-ve.

V. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit,
- Zyrës së Personelit
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS



[Signature]
Ramiz Lladrovci